



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni Pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 28.3.2017 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Slavko Simić, Milka Vuletić dhe Saša Milosavljević.

Munguan: Fisnik Ismaili, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Pjesëmarrës të tjerë: Senad Karaahmetovic, përfaqësues nga OSBE-ja; Hajrudin Skenderi, përfaqësues nga Ambasada Zvicrane; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Nataša Prica-Tišma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtur më: 9.03.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-132 për Automjete me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;
4. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, me theks të veçant tha se anëtarët e LS, për disa muaj nuk ka marrë pjesë në takimet parlamentare dhe ja sot jemi kthyer me vullnetin më të mirë që të vazhdojnë aktivitetet e rregullta të punës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja, hodhi në votim rendin e ditës dhe pasi nuk pati propozime shtesë, ajo konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtur më: 9.03.2017

Kryetarja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të mbajtura më 9.03.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-132 për Automjete me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-132 për Automjete dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim apo sygjerim në raport me amendamente të Komisionit Funksional.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-132 për Automjete dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Të ndryshme.

Kryetarja, kërkoi të informohet për rrjedhën e aktiviteteve të punës së komisionit në mungesë të pjesëmarrjes së anëtarëve të LS, për periudhën gjashtë mujore.

Agim Çeku, nënkryetar - informoi të pranishmit se në këtë periudhë, komisioni ka qen azhure dhe jan zhvilluar të gjitha aktivitetet sipas agjendës parlamentare.

Sa i përket temës lidhur me caktimin e grupeve punuese për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për financat e Pushtetit Lokal, tha se, komisioni ka vendos të tërhiqt kjo pikë e rendit të ditës me arsye të jen prezent të gjithë anëtarët nga rradha e komuniteteve.

Komisioni ka filluar procedurën e rishqyrtimit të Planit të Punës, rezultateve për tremujorin e dytë dhe plotësimi eventual të planit, për vitin 2017. Në takimin e fundit komisioni ka obliguar administratën për mbështetje të komisionit dhe administratorin e misionit të OSBES-së, që të përpilojnë draft programin me referenca të nevojshme me qëllim të realizimit të puntëorisë së punës, për periudhën e dytë të muajit prill.

Sipas Planit të Punës, komisioni ka parapar të vizitohet Mali i Zi, në muajin maj. Për realizimin e kësaj vizite është përcell shkresa në ambasadën e Malit të Zi me seli në Kosovë, por ende nuk kemi mar përgjegje.

Kryetarja, është e mendimit të njejtë, që në takimin e radhës të caktohen si pikë të veçantë; rishqyrtimi i planit të punës për tremujorin e dytë të vitit 2017, dhe caktimi i grupeve punuese për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për financat e Pushtetit Lokal.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti: Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Jasmina Živković